

Ndihma e Huaj

... nga Koordinimi tek Dialogu i Politikave Qeveri-Donatorë

Një bashkërendim më i madh i ndihmës së huaj me përparësitë strategjike kombëtare dhe procesin e planifikimit të buxhetit është objektivi kryesor i Sistemit të ri të Planifikimit të Integruar (SPI) të Qeverisë Shqiptare, miratuar në nëntor 2005 si një grup parimesh operative për të siguruar realizimin në mënyrë koherente, efikase dhe të integruar të politikave qeveritare, planifikimit dhe zbatimit të tyre. Efikasiteti i menaxhimit të ndihmës së huaj ka qenë një shqetësim i qeverisë dhe donatorëve që operojnë në Shqipëri për shumë vite dhe përpjekjet për ta trajtuar këtë çështje kanë kaluar nëpër ciklet e strukturimit institucional dhe të përmirësimit të procesit.

Pronësia dhe roli i Qeverisë në koordinimin e ndihmës së huaj ka ardhur duke u rritur që prej themelimit në vitin 2005 të Departamentit të Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së huaj (DEBASKON). Roli qendror koordinues i DEBASKON-it është të sigurojë lidhje organike midis politikave kryesore të ndihmës së huaj dhe proceseve financiare të qeverisë.

Sekretariati Teknik i Donatorëve (STD) është themeluar me qëllim që të lehtësojë një dialog të konsoliduar mes donatorëve dhe mes donatorëve dhe qeverisë. STD-ja, fillimisht i përbërë nga katër donatorë shumë-palësh (KE, OSBE, UNDP, Banka Botërore), që prej 2008 është zgjeruar me dy donatorë dy-palësh (Gjermania dhe Holanda), anëtarësimi i të cilëve është me rotacion vjetor (Gjermania dhe Holanda në 2009, Austria dhe Zvicra në 2011).

Dokumenti i Orientimit të Ndhmës së Huaj (DONH) u përgatit nga Qeveria Shqiptare në vitin 2008. Ky dokument ofron këndvështrimin e qeverisë në rolin e ndihmës së huaj në zhvillimin e Shqipërisë, dhe përparësitë e ndihmës së huaj në të ardhmen, për periudhën 2008-2013 në bazë të strategjive kombëtare dhe sektoriale të zhvillimit. Dokumenti identifikon gjithashtu mënyrat me të cilat qeveria do të sigurojë një rol më të madh drejtues në menaxhimin e ndihmës së huaj.

Shqipëria ka miratuar Deklaratën e Parisit mbi Efikasitetin e Ndhmës. Qeveria është e angazhuar të udhëheqë përparimin drejt veprimeve prioritare të identifikuar, duke marrë parasysh rekomandimet e Raportit analitik 2008 mbi Monitorimin, Deklaratën e Parisit dhe Agjendën e Accra-s për Veprim. *Harmonizimi i Planit të Veprimit* në arritjen e objektivave të Deklaratës së Parisit mbi efikasitetin e Ndhmës në Shqipëri u përgatit bashkërisht nga DEBASKON-i dhe nga Sekretariati Teknik i Donatorëve dhe u miratua nga komuniteti i donatorëve në nëntor 2009. Një nga veprimet konkrete për të thelluar implementimin e Planit për Veprim harmonizues ishte përmbushja, në shtator 2010, e vlerësimit të sistemit të prokurimeve të vendit, bazuar në metodologjinë e OECD/DAC. Vlerësimi për monitorimin e deklaratës së Parisit për vitin 2011, i cili u ndërmor në periudhën janar-mars, do të publikohet në shtator dhe do të sigurojë informacione të rinfreskuara lidhur me progresin që është bërë në drejtim të arritjeve të objektivave të Deklaratës së Parisit.

Po ndërtohet gjithashtu dhe Sistemi i Informacionit për Menaxhimin e Ndhmës së Huaj (SIMNH). Modulet kryesore të SIMNH konsistojnë në një profil të projektit dhe përdorim në formë gjurmimi që i mundëson DEBASKON-it të vlerësojë kontributin e projekteve të ndihmës së huaj për përparësitë strategjike sektoriale, të kontrollojë statusin e projekteve përmes ciklit të projektit që prej miratimit në koncept deri në zbatimin e tij për t'u siguruar që planet janë në rrugë të mbarë dhe pritshmëritë të realizohen. Gradualisht SIMNH-ja do të lidhet me Programin Buxhetor Afatmesëm dhe sistemin e Thesarit.

Që prej vitit 2004, Koordinimi i Ndhmës së huaj në nivel sektori mbështetet nga ana e **Grupeve Sektoriale të Punës (SWG)** të përbërë nga përfaqësues të qeverisë dhe donatorëve.

Janë krijuar rreth 30 Grupe Sektoriale Pune. Ato ndahen sipas pesë prioriteteve strategjike të SKZHI.

Janë mbajtur rreth 33 takime të grupeve Sektoriale të Punës. Takimet përqendrohen në shkëmbimin e informacionit për projektet në vazhdim e sipër, por gradualisht ato po fokusohen gjithashtu në kërkimin, çështje të koordinimit të politikave, të prioriteteve të ndihmës dhe monitorimit të zbatimit.

Një nga sfidat e ardhshme afatshkurtra të DEBASKON-it, agjencive të STD dhe pikave kryesore të donatorëve, është të zgjerojë pronësinë e qeverisë dhe udhëheqjen e ministrive të linjës në Grupet Sektoriale të Punës.